

**KONTRATË KONÇESIONI  
PËR  
SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

**Ndërmjet**

**MINISTRISË SË FINANCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**dhe**

**BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE:  
GLOBAL FLUIDS INTERNATIONAL S.A. DHE PETROLEUM CONSULTING PARTNERS A.G.**

**Tiranë, \_\_.\_\_. 2013**

**KJO KONTRATË** lidhet më \_\_\_\_\_.2013, në Tiranë, Shqipëri

**Ndërmjet:**

**Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë** (në vijim referuar si “**Autoriteti Kontraktues**”) e përcaktuar si autoritet kontraktues në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 609, datë 24.08.2011, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me Konçesion të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, përfaqësuar nga Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë, Z Ridvan Bode.

**dhe**

**Bashkimit të përkohshëm të shoqërive** (në vijim referuar si “**Konçesionari**”): **Global Fluids International S.A., (GFI)**, një shoqëri e themeluar ne St. Christopher dhe Nevis, me seli ne adresën P.O. Box 556, Main Street, Charlestown, Nevis, me numër regjistrimi C.20985 dhe **Petroleum Consulting Partners A.G. (PCP)**, një shoqëri e themeluar ne Baar, Zug, Zvicër me seli ne adresën Lindenstrasse 6, 6341 Baar, me numër regjistrimi 1034-508-84 në cilësinë e Konçesionarit, rregullisht i pranuar nga Autoriteti Kontraktues me shkresën e Ministrit të Financave Nr.14859/20Prot, datë 10.01.2013, bashkëlidhur në Shtojcën 1 të kësaj Kontrate;

Bashkimi i Përkohshëm kryesohet nga shoqëria **Global Fluids International S.A., (GFI)** dhe do të përfaqësohet nga Z. Gadi Gonen sipas prokurave të posaçme të lëshuara përkatësisht nga GFI në datën 06.05.2012 dhe nga PCP në datën 07.05.2012 bashkëlidhur në Shtojcën 1 të kësaj Kontrate.

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari referohen në këtë Kontratë si Palët dhe secili prej tyre si Palë.

**DEKLARIME PARAPRAKE**

Në përputhje me bazën ligjore si më poshtë:

- Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për konçesionet”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.61/2012, datë 24.5.2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 19.01.2007, “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së konçesioneve”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 24.08.2011, “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me Konçesion të shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”,

Autoriteti Kontraktues është i autorizuar që të nënshkruajë këtë Kontratë;

Ndërsa

## **KONTRATË KONÇESIONI PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

- (A) Konçesionari ka paraqitur më 07.12.2010 një propozim të pakërkuar në lidhje me Konçesionin e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të karburanteve, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti;
- (B) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka pranuar përmes Vendimit Nr. 609, datë 24.08.2011, "Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me Konçesion të shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë", dhënien me Konçesion të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë duke përcaktuar Ministrinë e Financave si Autoritetin Kontraktues;
- (C) Autoriteti Kontraktues ka publikuar në Buletin nr. 12, datë 26.03.2012 të Agjencisë së Prokurimit Publik, të ndryshuar me Buletin nr. 14, datë 09.04.2012, "Dokumentet e procedurës së konkurimit për dhënien e Konçesionit mbi shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë";
- (D) Konçesionari ka paraqitur më 14.05.2012, Ofertën Financiare dhe Ofertën Teknike në lidhje me Konçesionin mbi Shërbimin e Markimit dhe Monitorimin të Karburanteve, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti;
- (E) Autoriteti Kontraktues i ka dërguar Konçesionarit më 21.09.2012 "Njoftimin e Fituesit", duke pranuar propozimin e paraqitur nga Konçesionari;
- (F) Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari nënshkruajnë këtë Kontratë Koncesioni me qëllimin dhe angazhimin për të zbatuar Konçesionin në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë;
- (G) Konçesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i kësaj Kontrate, do të themelojë një shoqëri aksionare/me përgjegjësi të kufizuar, së cilës, përveçse për sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në nenin 7.2.3 të kësaj Kontrate, do ti transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera të Konçesionarit sipas kësaj Kontrate.

**Për sa më lart, palët bien dakord si më poshtë vijon:**

### **Neni 1 Përkufizimet dhe interpretimi**

Përveç termave të tjera të përkufizuara ndryshe në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

**"Autoriteti Kontraktues"** është Ministria e Financave, e cila, në cilësinë e autoritetit shtetëror kompetent ka të drejtën të lidhë Kontratën e Koncesionit;

**"Çmimi"** është çmimi që i paguhet Konçesionarit për Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Kontrate;

**"Data Efektive"** është data në të cilën janë plotësuar kushtet e paraqitura në nenin 4, pika 2 të kësaj Kontrate;

**"Data e Fundit Kontabël"** do të thotë 31 Dhjetori i çdo viti kalendarik;

**"Depozitat e Konçesionarit"** quhen depozitat e veçanta të Konçesionarit për mbajtjen e markuesit, që plotëson standartet e industrisë për këto lloj depozitash dhe plotësojnë kushtet e përcaktuara në Shtojcën 3 "Specifikimet Teknike";

**"Dokumentat e Tenderit"** janë dokumentat standarte të procedurës konkurruese për dhënien me koncesion të "Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë" të

## **KONTRATË KONÇESIONI PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

hartuara nga Autoriteti Kontraktues, të publikuara në Buletinin nr. 12, datë 26.03.2012 të Agjencisë së Prokurimit Publik, të ndryshuar me Buletinin nr. 14, datë 09.04.2012, "Dokumentet e procedurës së konkurrimit për dhënien e Konçesionit mbi shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur si Shtojca 2 e kësaj Kontrate, "Dokumentat e Tenderit";

**"Faza e Projektit"** konsiderohet afati gjatë së cilit Konçesionari do të hartojë dhe do të paraqesë për miratim Autoritetit Kontraktues, Projektin e zbatimit të konçesionit. Kjo fazë fillon pas Datës Efektive të Kontratës dhe përfundon në datën në të cilën Projekti është miratuar në mënyrë përfundimtare nga Autoriteti Kontraktues, sipas parashikimeve të nenit 5, pika 1 të kësaj Kontrate Konçesioni;

**"Faza e Zbatimit"** konsiderohet afati, i cili fillon pas miratimit përfundimtar të Projektit dhe Tabelës së Punimeve dhe mbaron në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, sipas parashikimeve të nenit 4 të kësaj Kontrate Konçesioni;

**"Garancia e Kontratës"** është shuma prej 208,500 (dyqind e tetë mijë e pesëqind) USD që përkon me 5% (pesë) përqind të vlerës së Projektit, vlerë e cila, siç rezulton nga formulari i njoftimit të fituesit dërguar nga Ministria e Financave nr.14859/2 datë 21.09.2012, është 4.170.000 (katër milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë) USD;

**"Konçesion"** është Shërbimi i Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve që do të ofrohet nga Konçesionari për qëllime të kontrollit fiskal në Republikën e Shqipërisë, ku Shërbimi i Markimit konsiston në injektimin e markuesit në produktet e përcaktuara në këtë Kontratë, ndërsa Shërbimi i Monitorimit konsiston në kontrollin për efekte të evazionit fiskal të subjekteve që janë të detyruara të kryejnë markimin e produkteve të specifikuara, sipas mënyrave dhe procedurave të përshkruara në këtë Kontratë dhe në shtojcat e saj;

**"Konçesionari"** do të thotë Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, Palë në këtë Kontratë, i cili në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me objektin e Konçesionit;

**"Kontratë"** quhen nenet e kësaj marrëveshje të nënshkruar midis Konçesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, së bashku me Deklaratat Paraprake dhe Shtojcat që i bashkëlidhen;

**"Markues"** është një substancë me element unik sigurie, e cila kur shtohet në sasi të vogla në karburant ose në naftën bruto trazohet lehtësisht dhe mund të gjurmohet me saktësi të lartë në çdo moment, sipas përcaktimeve të Shtojcës 6 "Sistemi Operativ";

**"Menaxheri i Projektit"** quhet çdo person i emëruar i tillë nga Autoriteti dhe Konçesionari, në përputhje me Shtojcën 10 të kësaj kontrate, "Marrëdhëniet midis Palëve";

**"Mospërbushje e Përsëritur e Konçesionarit"** konsiderohen rastet, me përjashtim të rasteve të Forcës Madhore, në të cilat Autoriteti Kontraktues i ka dërguar Konçesionarit dy njoftime me shkrim në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17 të Kontratës, duke i kërkuar përbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 7.2.2 pikat (i), (ii), (iii), (iv), (xi), (xii) dhe (xiii) dhe ky i fundit nuk ka realizuar përbushjen e tyre brenda afateve të njoftimit në të dyja herët;

**"Mospërbushje e Përsëritur e Autoritetit Kontraktues"** konsiderohen rastet, me përjashtim të rasteve të Forcës Madhore, në të cilat Konçesionari i ka dërguar Autoritetit Kontraktues dy njoftime me shkrim në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 17 të Kontratës, duke i kërkuar përbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 6.2, dhe ky i fundit nuk ka realizuar përbushjen e tyre brenda afateve të njoftimit në të dyja herët;

**"Nënkontraktues"** quhet çdo palë e tretë me të cilën Konçesionari bën një marrëveshje nënkontraktimi;

**"Oferta Financiare"** është pjesa e ofertës së paraqitur nga Konçesionari gjatë pjesëmarrjes së tij në procedurën konkurruese për dhënien me konçesion të "Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të

## **KONTRATË KONÇESIONI PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

Karburanteve në Republikën e Shqipërisë” në datën 14.05.2012, e cila përmban informacione të detajuara financiare dhe çmimin e ofertës në lidhje me Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit;

“**Oferta Teknike**” është pjesa e ofertës së paraqitur nga Konçesionari gjatë pjesëmarrjes së tij në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të “Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve në Republikën e Shqipërisë” në datën 14.05.2012, e cila përmban informacione të detajuara teknike në lidhje me Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit si dhe rezultatet e testit fizik;

“**Pasqyrat Financiare**” do të thotë pasqyrat financiare të Konçesionarit për vitin financiar të Datës së Fundit Kontabël, të dorëzuara pranë autoriteteve tatimore kompetente;

“**Pajisjet dhe makineritë e Konçesionarit**”, quhen të gjitha pajisjet Hardware dhe Software dhe të gjitha makineritë dhe pajisjet e tjera që shërbejnë për realizimin e Konçesionit, sipas përcaktimeve të Shtojcës 3 të kësaj Kontrate, “Specifikimet teknike”;

“**Pikat e Markimit dhe Monitorimit**” janë pikat ku ndodhen Produktet e Markimit dhe Monitorimit, duke përfshirë por pa u kufizuar, pikat doganore të import-eksportit, depozitat/magazinat doganore, pikat e prodhimit dhe rafinimit të naftës krudo si dhe pikat e tregtimit;

“**Produktet e Markimit dhe Monitorimit**” janë produktet objekt i Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit dhe specifikisht produktet e bardha (gazoil dhe benzen), produktet e zeza (solar dhe mazut), nafta bruto, lendet djegëse dhe produktet e ndërmjetme, sipas përcaktimeve të Aneksit VII, pika 2, të Dokumentave të procedurës së konkurrimit për dhënien e Konçesionit “Mbi shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë”, të përfshira në Shtojcën 4 të kësaj Kontrate “Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit”;

“**Projekti**” është projekti i Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, i paraqitur nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues pas Datës Efektive në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 5 të kësaj Kontrate, i cili përmban përshkrimin e detajuar teknik të të gjitha fazave të zbatimit të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit;

“**Sistemi Operativ**” quhet tërësia e pajisjeve dhe materialeve të përdorura nga Konçesionari për realizimin e Kontratës së Konçesionit, përfshirë Markuesin, Sistemin automatik të kompjuterizuar të injektimit, Sistemin në terren/portativ për kontrollin e karburanteve, Sistemin e Monitorimit dhe Kontrollit, siç përcaktohen në Shtojcën 6 të kësaj Kontrate, “Sistemi Operativ”;

“**Specifikimet Teknike**” janë përcaktimet e përmbajtura në Aneksin VII të Dokumenteve të Tenderit, i paraqitur nga Konçesionari si Oferta Teknike në datën 14.05.2012, siç përcaktohen në Shtojcën 3 të kësaj Kontrate, “Specifikimet teknike”;

“**Subjektet e Detyruara**” janë të gjithë subjektet të cilat tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonë, prodhojnë, rafinojnë ose kryejnë çdo aktivitet tjetër tregtar me Produktet e Markimit dhe Monitorimit, që janë të detyruar sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kësaj Kontrate të kryejnë Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit të Karburanteve pranë Konçesionarit;

“**Shërbimi i Markimit dhe Monitorimit**” është procesi i markimit dhe monitorimit të Produkteve të Markimit dhe Monitorimit, i kryer në përputhje me parashikimet e Ofertës Teknike të paraqitur nga Konçesionari në përputhje me Dokumentat e Tenderit, me anë të procedurave dhe të pajisjeve të përcaktuara në ofertën e tij;

“**Shoqëria Koncesionare**” është shoqëria që do të themelohet nga Konçesionari në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenin 7.2.2 (iv) të kësaj Kontrate;

“**Tabela e Punimeve**” është pjesa përbërëse e Projektit e cila përmban përshkrimin e hollësishëm të punimeve dhe afatet e punimeve që do të kryhen nga Konçesionari për të realizuar dhe zbatuar Projektin;

“**Tarifa Koncesionare**” është tarifa që Konçesionari do ti paguajë Autoritetit Kontraktues gjatë gjithë kohëzgjatjes së Koncesionit, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Kontrate;

“**Te ardhura** konsiderohen të ardhurat vjetore që realizohen nga shitja e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, siç rezultojnë nga Pasqyrat Financiare të vitit përkatës;

“**TVSH**” është tatimi mbi vlerën e shtuar që aplikohet në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 2 Objekti i Koncesionit**

2.1. Objekti i Koncesionit është kryerja, nga Konçesionari, e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, për qëllime fiskale, në Republikën e Shqipërisë. Shërbimi i Markimit dhe Monitorimit do të kryhet mbi Produktet e Markimit dhe Monitorimit të përcaktuara në Aneksin VII, pika 2, të Dokumenteve të procedurës së konkurrimit për dhënien e Koncesionit “Mbi shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë”, të përfshira në Shtojcën 4 të kësaj Kontrate “Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit”.

2.2 Realizimi i objektit të Koncesionit do të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë, Shtojcat e saj, legjislacionin fiskal në fuqi dhe çdo lloj akti ligjor apo nënligjor drejtpërdrejt të zbatueshëm apo të lidhur me Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit.

### **Neni 3 Çmimi, Tarifa Koncesionare dhe Mënyra e Pagesës**

3.1. Çmimi i Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit për njësi do të jetë 614 (gjashtëqind e katërmëdhjetë) Lekë për 1000 (njëmijë) Litra të markuara (pa TVSH).

3.2. Konçesionari do të jetë përgjegjës për ofrimin e Shërbimeve të Markimit dhe Monitorimit, të cilat specifikohen në mënyrë të detajuar në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshje “Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit”, ndaj çdo Subjekti të Detyruar. Konçesionari do të jetë përgjegjës për krijimin dhe administrimin e një rrjeti pikash shitjeje ku Subjektet e Detyruara, do të drejtohen për blerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit dhe pagesën e Çmimit. Konçesionari mbledh drejtpërdrejt Çmimin e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit.

3.3. Subjektet e Detyruara, do t’i paraqesin Konçesionarit një dokument që provon pagesën e Çmimit të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, në mënyrë që të përfitojnë nga Konçesionari Shërbimin e Markimit dhe Monitorimit.

3.4. Konçesionari çdo muaj do t’i japë Autoritetit Kontraktues një përmbledhje të detajuar në lidhje me sasinë e karburantit të markuar dhe monitoruar gjatë muajit paraardhës.

3.5. Konçesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues një Tarifë Koncesionare të barabartë me 2.5% (dy pikë pesë përqind) të të ardhurave vjetore që realizohen nga shitja e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, siç rezulton nga Pasqyrat Financiare të po atij viti.

3.6. Tarifa Koncesionare do të paguhet nga Konçesionari brenda 4 (katër) muajve të parë të secilit vit kalendarik bazuar në Pasqyrat Financiare të audituara, nëse është e aplikueshme, që i përkasin vitit financiar paraardhës.

### **Neni 4 Kohëzgjatja e Koncesionit**

## **KONTRATË KONÇESIONI PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

- 4.1. Kohëzgjatja e Konçesionit është 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga Data Efektive.
- 4.2. Data Efektive e fillimit të Konçesionit do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:
- i. nënshkrimi i kësaj Marrëveshje nga të dyja Palët;
  - ii. krijimi i Shoqërisë Koncesionare që do të implementojë Koncesionin;
  - iii. miratimi dhe hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
  - iv. miratimi dhe hyrja në fuqi e udhëzimit të Ministrit të Financave për zbatimin e Kontratës së Konçesionit, nëse është e nevojshme.

Autoriteti Kontraktues merr përsipër ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshme ligjore dhe nën-ligjore për zbatimin e Kontratës së Koncesionit.

4.3. Me përmbushjen e kushteve të mësipërme, Autoriteti Kontraktues do t'i dërgojë Konçesionarit njoftimin mbi Datën Efektive të fillimit të Konçesionit.

4.4. Konçesionari duhet të fillojë zbatimin e Fazës së Projektit, duke filluar nga Data Efektive siç parashikohet në nenin 5 më poshtë.

4.5. Palët bien dakort se kohëzgjatja e Konçesionit do të shtyhet, vetëm kur ekzistojnë arsyet e mëposhtme objektive të pavarura nga vullneti i Palëve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë dhe vonojnë zbatimin e Projektit të Konçesionit. Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk do të jetë më e shkurtër se periudha e vonesës së shkaktuar.

- i. Palët bien dakort se kohëzgjatja e Konçesionit do të shtyhet në rast të një ngjarje të konsideruar Forcë Madhore, kohëzgjatja e së cilës nuk kalon 120 ditë, për një periudhë kohore të barabartë me kohëzgjatjen e Forcës Madhore dhe për periudhën kohore që në mënyrë të arsyeshme konsiderohet e nevojshme për të ndrequr dëmet e shkaktuara.
- ii. Në rast se Konçesionari ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë të Kontratës së Koncesionit, Konçesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues me shkrim për vonesën, shkakun dhe periudhën e ndërprerjes së shërbimeve. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë objektivisht kërkesën dhe në rast se është dakort me vonesën, shtyrja e afatit do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të Kontratës.

### **Neni 5 Realizimi i Koncesionit**

5.1. Faza e Projektit: Konçesionari duhet të realizojë dizenjimin e plotë të strukturës të Projektit brenda 90 ditëve nga Data Efektive. Në përmbajtjen e Projektit duhet të jenë përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me Ofertën Teknike të dorëzuar nga Konçesionari. Autoriteti Kontraktues mund të paraqesë vërejtjet dhe sugjerimet mbi Projektin brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së tij. Konçesionari duhet të bëjë korrigjimet në Projekt brenda 30 ditëve dhe ta riparaqesë Projektin për miratim tek Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk do të refuzojë pa arsye miratimin e Projektit dhe do ta miratojë brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së tij. Në rast se Autoriteti nuk shprehet brenda 10 ditëve, konsiderohet se e ka miratuar Projektin dhe se nuk ka asnjë vërejtje apo sugjerim në lidhje me të. Pas miratimit përfundimtar të Projektit, nga Autoriteti Kontraktues, Projekti do të jetë Shtojcë e Kontratës, duke u bërë pjesë integrale e saj.

5.2. Faza e Zbatimit: Konçesionari do të kryejë punimet për zbatimin e objektit të kësaj Kontrate në përputhje me afatet dhe cilësinë e kërkuar dhe të rënë dakort sipas nenit 5.1. më sipër. Pjesë përbërëse e Projektit do të jetë Tabela e Punimeve. Në rast të ndonjë vonese në ekzekutim për shkaqet e parashikuara në nenin e mësipërm 4.5, Palët bien dakort dhe pranojnë se afatet e Tabelës së Punimeve

do të modifikohen me anë të marrëveshjes së përbashkët me shkrim. Në këto raste shtyrja e afatit do të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e vonesës së shkaktuar.

5.3. Pjesë përbërëse e Projektit, sipas nenit 5.1. më sipër, do të jete përcaktimi në mënyrë të detajuar i Pikave të Markimit dhe Monitorimit.

5.4 Shërbimet e Markimit dhe të Monitorimit të ofruara nga Konçesionari janë në përputhje me Ofertën Teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe përcaktimet e Shtojcës 4 të kësaj Kontrate, "Shërbimet e Markimit dhe Monitorimit";

5.5 Sistemi Operativ do të mbulojë me markim Produktet e Markimit dhe Monitorimit të cilat taksohen sipas secilës prej kategorive:

- i. pagesë e plotë e të gjitha taksave;
- ii. pagesë e pjesshme, si përshembull përjashtim nga pagimi i akcizës dhe pagesë e të gjitha taksave të tjera;

sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

5.6 Me anë të Sistemit Operativ Koncesionari do të jetë në gjendje të identifikojë në mënyrë të shpejtë dhe të saktë përqendrimin e markuesit, sipas specifikimeve teknike të Shtojcës 3 të kësaj Kontrate, "Specifikimet teknike", me qëllim ndalimin e deklarimit të rremë apo të gabuar, të përzjerjes së karburantit me lloje të tjera që i nënshtrohen një sistemi tjetër taksimi dhe përzjerjes me lëndë të tjera.

5.7 Sistemi i injektimit do të jetë automatik apo manual, dhe në çdo rast i integrueshëm me sistemin e markimit, siç specifikohet në Shtojcën 6 të kësaj Kontrate, "Sistemi Operativ"

5.8. Konçesionari do të kryejë investimet e nevojshme për realizimin e Projektit, siç specifikohet në Shtojcën 5 të kësaj Kontrate, "Plani i Investimeve";

5.9. Konçesionari do të administrojë Sistemin Operativ, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Konçesionit sipas përshkrimit dhe detajimit të përcaktuar në Shtojcën 6 të kësaj Kontrate, "Sistemi Operativ";

5.10. Konçesionari duhet të rinovojë sistemin nëpërmjet përditësimit dhe kalibrimit përgjatë kohëzgjatjes së Koncesionit dhe përpara përfundimit të afatit të tij. Përcaktimi i rinovimit të sistemit dhe të pajisjeve duhet të bëhet në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara ne Shtojcën 7 të kësaj Kontrate, "Rinovimi i sistemit";

5.11 Konçesionari duhet të marrë masa për trajnimin e përshtatshëm të personelit të tij dhe të personelit të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e markimit dhe monitorimit në përputhje me Shtojcën 8 të kësaj Kontrate "Trajnimi i personelit";

5.12. Konçesionari duhet të përdorë teknologjinë e përcaktuar në Ofertën Teknike të paraqitur prej tij para Autoritetit Kontraktues në datën 14.05.2012;

5.13. Me qëllim realizimin e suksesshëm të Koncesionit, eliminimin e pengesave objektive dhe për të mundësuar bashkëpunimin efektiv të Palëve, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate, secila nga Palët do të emërojë një Menaxher Projekti, i cili do të ketë funksionet e përcaktuara në Shtojcën 10 të kësaj Kontrate, "Marrëdhëniet midis Palëve"

### **Neni 6**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

6.1. Autoriteti Kontraktues do të ushtrojë të drejtat e parashikuara më poshtë:

- i. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën që të monitorojë, inspektojë, kontrollojë dhe mbikqyrë çdo fazë të zbatimit të Kontratës, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, me qëllim që të verifikojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit. Kontrolli i ushtruar nga ana e



Autoritetit Kontraktues do të përfshijë kontrollin teknik mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Konçesionari.

- ii. Konçesionari do të pajisë Autoritetin Kontraktues me një detektor/analizator, i cili mund të përdoret nga ky i fundit gjatë gjithë periudhës 10 vjeçare të kohëzgjatjes së Konçesionit. Detektori/analizatori do t'i jepet Autoritetit Kontraktues nga Konçesionari falas dhe kalibrimi i tij do të kryhet në përputhje me të njëjtat kushte kalibrimi të vendosura për Paisjet dhe Makineritë e Konçesionarit. Detektori/analizatori në dispozicion të Autoritetit Konçesionar do të përdoret me qëllimin e vetëm të monitorimit të aktivitetit të Konçesionarit në përputhje me të drejtat e monitorimit që Autoriteti Kontraktues ka kompetencën të kryejë sipas kësaj Kontrate. Detektori/analizatori nuk do të përdoret nga Autoriteti Kontraktues për asnjë qëllim tjetër, përveç atij të përmendur në këtë nen.
  - iii. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që të ushtrojë mbikqyrjen e përgjithshme çdo 6 muaj, gjatë zbatimit dhe funksionimit të Kontratës, në mënyrë që të verifikojë se kryerja e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, cilësia dhe konformiteti i tyre janë në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe me Projektin e paraqitur nga Konçesionari dhe të miratuar nga Autoriteti.
  - iv. Përveç sa parashikohet në paragrafin 6.1.iii me sipër, në rastet kur sipas informacioneve të arsyeshme dhe të besueshme Autoriteti Kontraktues është në dijeni të mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate, mund të ushtrojë monitorimin në çdo kohë.
  - v. Në rast të shkeljes së kushteve të Kontratës së Konçesionit të vërejtura gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Konçesionari do të njoftohet me shkrim në lidhje me masat që do të ndërmerren dhe detyrimet që duhet të përmbushen, si dhe në lidhje me mënyrën dhe kushtet e përmbushjes së tyre.
- 6.2. Autoriteti Kontraktues merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:
- i. Të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet që të përmbushë brenda afateve të arsyeshme dhe pa vonesa veprimet e përcaktuara në nenin 4.2.
  - ii. Të garantojë vazhdimësinë e zbatimit të Kontratës së Konçesionit, pavarësisht nga ndryshimet e objektivave apo të legjisllacionit në Shqipëri në lidhje me sektorin ku vepron Konçesionari.
  - iii. Të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar Konçesionarin në raportet me organet e administratës shtetërore, qendrore dhe lokale dhe entitetet private, në lidhje me çdo pengesë që mund të haset gjatë procedurave të lëshimit të lejeve, licencave, autorizimeve ose çdo lloj tjetër dokumenti i cili është i nevojshëm për zbatimin e objektit të Konçesionit, brenda përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
  - iv. Të bëjë përpjekjet e duhura, përmes udhëzimeve apo akteve të tjera normative në kompetencë të saj, për të siguruar që të gjitha organet e administratës shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre në lidhje me Konçesionin, të jenë të informuara në mënyrën e duhur në lidhje me ekzistencën e kësaj Kontrate dhe që të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme, me Konçesionarin për të mundësuar kryerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit.
  - v. Të garantojë dhe të mundësojë aksesin e lirë të Konçesionarit në të gjitha Pikat e Markimit dhe Monitorimit të tregut shqiptar të Produkteve të Markimit dhe të Monitorimit. Ky akses është vendimtar për aftësinë e Konçesionarit për të realizuar detyrimet e marra përsipër prej tij në Kontratën e Konçesionit.
  - vi. Të ndihmojë Konçesionarin, kur i kërkohet, në zhvillimin e Projektit dhe në përgjithësi në zbatimin e kësaj Kontrate. Veçanërisht Autoriteti Kontraktues do të sigurojë dhe do të mundësojë kur është e nevojshme, hyrjen e Konçesionarit në të gjitha Pikat e Markimit dhe të Monitorimit. Autoriteti Kontraktues do të garantojë gjithashtu sigurinë e kryerjes së Shërbimeve të Markimit dhe Monitorimit të kryera nga Konçesionari me anë të stafit të tij.

- vii. Autoriteti Kontraktues angazhohet se do të propozojë të gjitha ndryshimet e nevojshme për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës dhe do të marrë iniciativën për miratimin e të gjitha ligjeve, akteve nënligjore dhe/ose rregulloreve që ndalojnë dhe penalizojnë, hedhjen në qarkullim, tregtimin, eksportin dhe shpërndarjen dhe importin në momentin e pagimit të akcizës si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar me Produktet e Markimit dhe Monitorimit, të cilat nuk janë të markuara në momentin që bëhet e detyrueshme pagesa e detyrimeve tatimore, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e kësaj Kontrate dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 7

#### Të drejtat dhe detyrimet e Konçesionarit

- 7.1. Konçesionari, gjatë zbatimit të Konçesionit, do të ushtrojë të drejtat e mëposhtme:
- i. Do të kërkojë nga Autoriteti Kontraktues që të garantojë respektimin e plotë, edhe nga palët e treta, të të drejtave dhe kompetencave që i janë dhënë Konçesionarit me anë të kësaj Kontrate;
  - ii. Do të kërkojë nga Autoriteti Kontraktues garantimin e rendit publik dhe zbatimin në kushte sigurie të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në aksesin në të gjitha Pikat e Markimit dhe Monitorimit.
  - iii. Do të kërkojë, përmbushjen e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues në çdo rast, kur ky i fundit nuk i përmbush ato plotësisht ose vonon përmbushjen e tyre.
  - iv. Të drejtat e Konçesionit do të jenë ekskluzive dhe Konçesionari do të ketë të drejtën e vetme dhe ekskluzive të ushtrojë të drejtat e Konçesionit të dhëna sipas kësaj Kontrate.
  - v. Për aq sa është e zbatueshme, Konçesionari duhet të pajiset nga Autoriteti Kontraktues me të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe për realizimin e objektit të Konçesionit. Për të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetence të lëshojë leje, licenca ose autorizime, Konçesionari ka të drejtë të kërkojë asistencën e Autoritetit Kontraktues për marrjen e tyre.
- 7.2. Konçesionari merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:
- 7.2.1. Detyrimet e përgjithshme të Konçesionarit
- i. Të zbatojë Konçesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Shtojcave të saj;
  - ii. Konçesionari duhet të kryejë të gjitha shërbimet objekt të Konçesionit dhe të përmbushë detyrimet e tij në përputhje me këtë Kontratë, Dokumentat e Tenderit, Ofertën Teknike, Ofertën Financiare, Projektin dhe në përgjithësi duke bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme, në mënyrë eficiente dhe ekonomike dhe në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale më të mira;
  - iii. Konçesionari duhet të ndjekë praktika të shëndosha biznesi, të përdorë teknologjinë e ofruar prej tij në Ofertën Teknike dhe në Projekt, si dhe të zbatojë metoda të sigurta pune;
  - iv. Konçesionari do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nën-kontraktorëve (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Shtojcave të saj;
  - v. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së Konçesionit, asetet e krijuara, të reja apo të rikonstruara gjatë periudhës së Konçesionit, së bashku me sistemet hardware dhe software do të transferohen Autoritet Kontraktues pa shpërblim;
  - vi. Konçesionari duhet të respektojë dhe të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

### 7.2.2. Detyrimet e veçanta të Konçesionarit;

- i. Konçesionari duhet të realizojë kryerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit objekt i Koncesionit si dhe duhet të kryejë investimet sipas planit të investimeve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 5 si dhe me Shtojcën 5 të kësaj Kontrate “Plani i Investimeve”.
- ii. Konçesionari do t'i raportojë mbi bazë një mujore Autoritetit Kontraktues ose personave të autorizuar prej tij, mbi progresin në Fazën e Zbatimit të Projektit, si dhe mbi zbatimin e shërbimeve të kërkuara në këtë Kontrate, gjatë Fazës së Zbatimit të shërbimit. Konçesionari mbart gjithashtu detyrimin të raportojë brenda nje kohe te arsyeshme, edhe në rastet kur i drejtohet një kërkesë specifike për raportim nga ana e Autoritetit Kontraktues ose personave të autorizuar prej tij;
- iii. Përveç sa më sipër, Konçesionari, në përputhje me Specifikimet Teknike, do të kryejë raportimin në kohë reale, brenda jo më shumë se 10 minutash, për çdo monitorim që ai do të kryejë;
- iv. Konçesionari është i detyruar të formojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, Shoqërinë Konçesionare, e cila do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë. Një kopje e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë koncesionare, do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues përpara aplikimit për regjistrim të shoqërisë së re si person juridik, për të marrë miratimin e Autoritetit Kontraktues. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk jep miratimin e tij brenda 10 ditëve pas paraqitjes se akteve themeluese, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik. Në mënyrë të veçantë, kërkohet që në përmbajtjen e statutit të Shoqërisë Koncesionare të përfshihen të paktën:
  - a) Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionare”, dhe do të funksionojë në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
  - b) Objekti i shoqërisë: Shoqëria Konçesionare do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e Projektit përfundimtar, ndërtimin dhe testimin e Sistemit Operativ, shfrytëzimin e Sistemit Operativ, ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe transferimin e pajisjeve të Sistemit Operativ tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të Koncesionit;
  - c) Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar, me kushtin që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, të kryejë ekskluzivisht aktivitet tregtar në përputhje me objektin e kësaj Kontrate;
  - d) Themeluesit e shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetëm nga shoqëritë anëtare të bashkimit të përkohshëm të miratuara nga Ministria e Financave, palë të kësaj Marrëveshje në cilësinë e Konçesionarit.
- v. Me krijimin e Shoqërisë Koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë Kontratë do të transferohen nga Konçesionari tek Shoqëria Koncesionare, duke filluar që nga data e regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin periudhës përpara themelimit të saj si dhe së bashku me të drejtat dhe detyrimet specifike të cilat i mbeten në ngarkim bashkimit të përkohshëm të shoqërive ofertuese, sipas kësaj Kontrate. Konçesionari dhe Shoqëria Koncesionare e krijuar, do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.
- vi. Në qoftë se është vendosur me vendim të formës së prerë nga gjykata ose nga një gjykatë arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Konçesionari duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me dëmet e shkaktuara, si pasojë e veprimeve direkte apo indirekte të tij, të kryera me faj. Konçesionari do të mbajë të pa dëmtuar Autoritetin Kontraktues;

## **KONTRATË KONÇESIONI PËR SHËRBIMIN E MARKIMIT DHE MONITORIMIT TË KARBURANTEVE**

- vii. Konçesionari duhet të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në zbatimin e Konçesionit;
- viii. Konçesionari, në përputhje me Shtojcën 3 "Specifikimet Teknike", dhe Shtojcën 6 "Sistemi Operativ", është i detyruar të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Sistemit Operativ gjatë periudhës së Konçesionit;
- ix. Konçesionari duhet të marrë të gjitha masat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të garantuar respektimin e parashikimeve të legjislacionit shqiptar mbi punësimin, sigurinë, disiplinën teknike, kushtet e sigurimit në punë, higjienën dhe mbrojtjen nga zjarri, trajnimin e personelit, në mënyrë që të parandalojë çdo dëm apo aksident në punë ashtu si dhe të shmangë dëmet ndaj mjedisit, pronës publike dhe private;
- x. Konçesionari duhet të përballojë shpenzimet e mbylljes së kësaj kontrate dhe përkatësisht për konsulentin e Autoritetit Kontraktues si dhe ato noteriale;
- xi. Konçesionari në përputhje me Shtojcën 8 të kësaj Kontrate, "Trajnimi i Personelit", do të realizojë trajnime të vazhdueshme për të gjithë personelin e Konçesionarit, i cili është punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit, si edhe të personelit të administratës shtetërore të përfshirë në procesin e Monitorimit;
- xii. Konçesionari duhet të garantojë Autoritetin Kontraktues që gjatë gjithë kohës së Konçesionit do të ketë rezerva në sasi të mjaftueshme të markuesit në Shqipëri, për të paktën tre (3) muaj.
- xiii. Përveçse nëse pranohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues ose përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë, Konçesionari do të përdorë Sistemin Operativ vetëm për ofrimin e Shërbimeve ndaj Autoritetit Kontraktues dhe nuk do ta përdorë atë për qëllimet personale të Konçesionarit ose për t'i ofruar Shërbime të tjera palëve të treta. Asetet e Konçesionarit do të jenë nën rrezikun dhe përgjegjësinë e Konçesionarit,
- xiv. Përveçse nëse shprehet në këtë Kontratë për të kundërtën, humbja ose shkatërrimi i ndonjë aseti të Konçesionarit në vendndodhjen e tij, nuk do të shkarkojë Konçesionarin nga detyrimet e tij për të ofruar Shërbime në përputhje me Kontratën.

### **7.2.3. Detyrime ekskluzive të anëtarëve të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në cilësinë e Konçesionarit**

- i. Shoqëritë anëtare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk do të kalojnë, lënë peng apo vendosin barrë, si dhe nuk do të transferojnë kuotat/aksionet e tyre në Shoqërinë Konçesionare pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues, përveçse nëse këto shoqëri e kalojnë pjesëmarrjen e tyre në kapital tek njëra – tjetra. Çdo transferim si më sipër do t'i njoftohet menjëherë Autoritetit Kontraktues.
- ii. Shoqëritë anëtare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive do të mbështesin plotësisht dhe do të jenë të përfshira në vënien në jetë të Konçesionit nga Shoqëria Konçesionare përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Konçesionit, ndërmjet të tjerash edhe me anë të:
  - a. sigurimit të burimeve të nevojshme, përfshirë edhe ato financiare, si dhe të ekspertizës, teknologjisë dhe njohurive sipas përcaktimeve të Ofertës Teknike dhe Ofertës Financiare paraqitur prej tyre;
  - b. sigurimit të ekspertëve për çështje parësore për realizimin e Konçesionit;
  - c. mbështetjes së vazhdueshme për Shoqërinë Konçesionare;
- iii. Pavarësisht nga transferimi i të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Kontrate tek Shoqëria Konçesionare, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara përpara datës së themelimit të Shoqërisë

Konçesionare, së bashku me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm 7.2.3, do të vazhdojnë të mbeten në ngarkim të shoqërive anëtare të bashkimit të përkohshëm të shoqërive, në cilësinë e Konçesionarit.

### **Neni 8 Pronësia Intelektuale**

8.1. Të drejtat tregtare të pronësisë intelektuale të solucionit të markimit të përdorur nga Konçesionari gjatë zbatimit të Shërbimit të Markimit dhe Monitorimit do të jenë në pronësi të vetme të Konçesionarit, i cili nuk do t'ia bëjë të ditur apo t'ia transferojë ato Autoritetit Kontraktues edhe pas mbarimit të kohëzgjatjes së Konçesionit.

8.2. Me përjashtim të parashikimit të nenit 8.1, të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale të zhvilluara rishtazi nga Shoqëria Konçesionare në Shqipëri gjatë zbatimit të Kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 9 Punësimi dhe Zëvendësimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm Financiar**

9.1. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë çdo të dhënë mbi integritetin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm Financiar të Shoqërisë Konçesionare që lidhet me ushtrimin e aktivitetit të parashikuar në këtë Kontratë. Konçesionari duhet të sigurojë miratimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara zëvendësimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të Drejtorit të Përgjithshëm Financiar. Autoriteti Kontraktues do të japë miratimin për zëvendësimin brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke mos e refuzuar atë pa arsye, dhe në rast se afati i mësipërm kalon pa miratim ose refuzim nga ana e Autoritetit Kontraktues, miratimi konsiderohet i dhënë në heshtje.

9.2. Nëse Autoriteti Kontraktues zbulon se Drejtori i Përgjithshëm ose Drejtori i Përgjithshëm Financiar ka kryer veprime të jashtëligjshme, ose Autoriteti Kontraktues për shkaqe të arsyeshme dhe objektive është veçanërisht i pakënaqur nga puna e tyre në zbatimin e kësaj Kontrate, atëherë Konçesionari duhet ta zëvendësojë këtë person brenda 45 ditëve nga kërkesa me shkrim e Autoritetit Kontraktues. Në rast se bëhet e nevojshme të zëvendësohet Drejtori i Përgjithshëm ose Drejtori i Përgjithshëm Financiar, Konçesionari duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime të barzvefshme ose më të mira.

### **Neni 10 Nënkontraktimi**

10.1 Nënkontraktimi do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës Konçesionari i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të Kontratës së tij një pale të tretë.

10.2 Konçesionari nuk duhet të nënkontrakttojë pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së Kontratës. Konçesionari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohen dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë Konçesionarin për vendimin e tij, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e miraton apo jo atë.

10.3 Autoriteti Kontraktues mund të refuzojë miratimin e tij kur konsideron, në baza të arsyeshme që:

- i. Miratimi i një nënkontraktori të propozuar nga Konçesionari mund të dëmtojë ofrimin e Shërbimeve të Markimit dhe Monitorimit ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Autoritetit Kontraktues;

- ii. Nënkontraktuesi i propozuar është konsideruar të jetë jo i besueshëm dhe/ose nuk ka ofruar shërbime të arsyeshme për klientët e tjerë të tij në dijeni të Autoritetit Kontraktues;
- iii. Nënkontraktuesi i propozuar punëson persona të papërshtatshëm për zbatimin e Shërbimeve të Markimit dhe Monitorimit.

10.4. Konçesionari është plotësisht dhe ekskluzivisht përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për zbatimin e Kontratës së Konçesionit dhe përmbushjes së detyrimeve të parashikuara prej saj, pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit, përfshirë shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga ky i fundit.

10.5 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

### **Neni 11 Sigurimi**

11.1. Konçesionari, gjatë gjithë kohëzgjatjes së Koncesionit duhet të nënshkruajë kontrata sigurimi profesional, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën përgjithësisht të njohura në lidhje me profesionin përkatës, në mënyrë që të kompensojë Autoritetin Kontraktues nga të gjitha dëmet e mundshme të shkaktuara gjatë zbatimit të Konçesionit. Për përmbushjen e qëllimit të këtij neni anëtar kryesues i Konçesionarit (GFI), zotëron një policë globale për sigurimin e aktivitetit në të cilën është përfshirë si përfitues edhe Autoriteti Kontraktues.

11.2. Polica e përshkruar në nenin 11.1 mbulon sigurimin e përgjegjësisë së Konçesionarit ndaj të tretëve. Në rast të dëmtimeve të shkaktuara nga veprimtaria e Konçesionarit, vlera e dëmit e kompensuar nga siguruuesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit, duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dëmet e shkaktuara. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruuesi do të paguajë për kompensimin e dëmit, do të përballohet nga Konçesionari.

11.3 Konçesionari duhet të sigurohet të paktën nga rreziqet që lidhen me aktivitetin e parashikuar nga kjo Kontratë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 për "Veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësisimit në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar, të cilat nuk janë të mbuluara nga polica e parashikuar në nenin 11.1, gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tyre/saj çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.

11.4 Në çdo rast, Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

### **Neni 12 Garancia e Kontratës**

12.1. Konçesionari, duhet të mbajë të vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Koncesionit Garancinë e Kontratës në shumën 208.500 (dyqind e tetë mijë e pesëqind) USD, të paraqitur në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate ose jo më vonë se 5 ditë nga nënshkrimi i saj. Garancia e Kontratës do të bashkëlidhet kësaj marrëveshje si Shtojca 9, "Garancia e Kontratës". Në rast se Garancia e Kontrates nuk depozitohet brenda afateve të parashikuara në këtë nen, Kontrata bëhet automatikisht e pavlefshme.

12.2. Garancia e kontratës i shërben Autoritetit Kontraktues si vlerë ekonomike nga e cila mund të kompensohet për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Konçesionarit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës. Autoriteti Kontraktues, përveç sa parashikohet në nenin 15.1, mund të tërheqë një shumë nga Garancia e Kontratës vetëm në rastet kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, ose vendim arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton kompensimin për dëmet e pësuar. Në rastet kur Autoriteti Kontraktues tërheq nga Garancia e Kontrates shuma të caktuara si pasojë e sanksioneve të parashikuara në nenin 15.1, Konçesionari duhet të plotësojë Garancinë e Kontratës duke rivendosur shumën e tërhequr për shkak të sanksionit.

12.3. Vlera e Garancisë së Kontratës do të zvogëlohet në përputhje me realizimin e Planit të Investimeve. Garancia e Kontratës do t'i kthehet Konçesionarit jo më vonë se 60 ditë pas përfundimit të kohëzgjatjes së Koncesionit.

### **Neni 13 Informacioni Konfidencial**

13.1. Secila nga Palët do të trajtojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet në lidhje me Projektin e Konçesionit, qofshin këto në formë të shkruar apo verbale, teknike apo tregtare, që u janë dhënë atyre nga ndonjë palë ose në emër të cilësdo Palë tjetër të Kontratës së Konçesionit, dhe nuk duhet të përhapë tek një palë e tretë, të gjitha apo pjesë të dokumenteve dhe informacionit, pa pranimin e shkruar të Palës tjetër apo në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

13.2. Konçesionari dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë konfidenciale të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me Kontratën e Konçesionit.

13.3. Konçesionari mund t'i japë nënkontraktorit dokumente, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktorin në mënyrë që ai të kryejë punën për të cilën është nënkontraktuar. Në rast të tillë Konçesionari duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që detyron ruajtjen e konfidencialitetit sipas parashikimit të dhënë në pikën 13.1 më sipër.

13.4. Këto dispozita nuk do të zbatohen në rast se:

- i. Ky informacion ka qenë në zotërim të Palës që bën zbulimin, i cili nuk ka pasur detyrimin e konfidencialitetit në atë moment;
- ii. Ky informacion ishte përfutur nga një palë e tretë e cila nuk ka detyrimin e konfidencialitetit;
- iii. Në kohën e zbulimit ky informacion ka qenë për përdorim publik;
- iv. Informacioni është marrë, gjetur, zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa pasur akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër;
- v. Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit.

### **Neni 14 Forca Madhore**

14.1 Ngjarjet e Forcës Madhore

Në këtë Kontratë, një Ngjarje e Forcës Madhore do të nënkuptojë zhvillimin në Republikën e Shqipërisë të njëres apo të gjitha ngjarjeve siç përcaktohen në këtë nen, të cilat pengojnë Palën që pretendon se ka pasur Forcë Madhore ("Pala e Prekur") nga përmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate dhe kjo ngjarje apo veprim:

- i. Është përtej kontrollit të arsyeshëm dhe nuk vjen për shkak të fajit të Palës së Prekur;
- ii. Pala e Prekur nuk ka qenë në gjendje ta zgjidhë këtë veprim apo ngjarje, duke ushtruar analizën, përpjekjet e arsyeshme, aftësinë dhe kujdesin e duhur;
- iii. Sjell pasoja materiale të padëshirueshme mbi zbatimin e Kontratës së Koncesionit.

14.2. Përcaktimi i Ngjarjeve të Forcës Madhore

Për qëllimet e Nenit 14.1 më lart, Ngjarja e Forcës Madhore do të nënkuptojë një ose më shumë nga veprimet apo ngjarjet në vijim:

- i. Veprime të fatkeqësive natyrore apo ndodhi përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së Prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të pritej që të ndodhnin, duke përfshirë por pa u kufizuar me kushte jashtëzakonisht të këqija të motit, tërmete, ciklone, përmblytje, shpërthime vullkanike, zjarre apo rrëshqitje toke;
- ii. Kontaminim radioaktiv ose rrezatim jonizues, apo kontaminim kimik ose biologjik;
- iii. Greva ose bojkotime që ndërpresin furnizimet dhe shërbimet ndaj Projektit për një periudhë që kalon 30 ditë në një vit financiar;
- iv. Një akt lufte, pushtim, konflikt i armatosur apo aktivitet i armiqve të vendit dhe/ose të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, të cilat e pengojnë mbledhjen e Çmimit nga Konçesionari për një periudhë që tejkalon kohën e vazhdueshme prej 30 ditësh brenda një viti financiar;
- v. Çdo ngjarje apo rrethanë tjetër që pengon përmbushjen e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Kontrate, në kuptim të nenit 14.1 më sipër.

### 14.3 Pasoja e ngjarjes së Forcës Madhore

Pas verifikimit të një Ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- i. Nuk do të ketë Zgjidhje të kësaj Kontrate, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 14.5 në vijim;
- ii. Kur Ngjarja e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, datat e parashikuara në zbatimin e Projektit dhe Kohëzgjatja e Koncesionit, do të shtyhen për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e Ngjarjes së Forcës Madhore;
- iii. Kur Ngjarja e Forcës Madhore ndodh pas Datës Efektive, Konçesionari do të vazhdojë të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të zbatuar Projektin dhe/ose për të mbledhur Çmimin e Koncesionit, por nëse ai është i paaftë apo nuk lejohet që ta bëjë këtë, Kohëzgjatja e Koncesionit, do të zgjatet për një kohë të barabartë me periudhën në të cilën mbledhja e Çmimit të Koncesionit është e pamundur për shkaqet e mësipërme.

### 14.4 Shpërndarja e kostove gjatë vazhimit të një Ngjarje të Forcës Madhore

Përgjatë kohëzgjatjes së Ngjarjeve të Forcës Madhore, Palët do të përballojnë kostot e tyre dhe asnjërës Palë nuk do t'i kërkohet që t'i paguajë Palës tjetër kosto që rrjedhin nga çfarëdo Ngjarje e Forcës Madhore.

### 14.5 Zgjidhja

Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore vazhdon apo, sipas gjykimit të arsyeshëm të Palëve ka të ngjarë të vazhdojë përtej një periudhe prej 120 ditësh, Palët mund të vendosin ta zgjidhin këtë Kontratë ose ta vazhdojnë zbatimin e kësaj Kontrate, mbi bazën e kushteve të reja të rena dakord bashkarisht me shkrim. Nëse Palët nuk janë në gjendje që të arrijnë një marrëveshje në lidhje me këtë, Pala e Prekur, pas kalimit të periudhës së përmendur prej 120 ditësh, do të ketë të drejtën ta zgjidhë këtë Kontratë duke lëshuar një Njoftim Zgjidhje. Në rast zgjidhje të Kontratës për shkak të Forcës Madhore, secila Palë përballon shpenzimet e veta të kryera deri në momentin kur filloi Ngjarja e Forcës Madhore. Autoriteti Kontraktues do të marrë në dorëzim investimin e kryer deri në atë moment në gjendjen "siç është".

### 14.6 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve në lidhje me Forcën Madhore

Në rastin kur Palët nuk janë në gjendje të bien dakord me mirëbesim në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e një Ngjarje të Forcës Madhore, kjo mosmarrëveshje do të zgjidhet përfundimisht në përputhje me Procedurën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, me kusht që, në çdo rast barra e provës në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e kësaj Ngjarje të Forcës Madhore, të jetë mbi Palën e Prekur.



14.7 Përgjegjësia për humbje dhe dëmtime

Përveçse siç parashikohet shprehimisht në këtë nen, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë lloj mënyre ndaj Palës tjetër në lidhje me çfarëdo humbje, dëmtime, kosto, shpenzime, pretendime, kërkesa dhe procedime, në lidhje me/apo që rrjedhin nga ndodhja ose ekzistenca e çfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, ose me ushtrimin e çfarëdo të drejte në përputhje me Nenin 14.

14.8 Detyrimi për të raportuar

Pala e Prekur do ti raportojë Palës tjetër mbi ndodhjen e një Ngjarje të Forcës Madhore dhe:

- i. Pala e Prekur nuk do të pretendojë asnjë lehtësim për/apo në lidhje me një Ngjarje të Forcës Madhore, përveçse kur ajo ka njoftuar Palën tjetër me shkrim mbi ndodhinë e një Ngjarje të Forcës Madhore, sa më shpejt që ka qenë e mundur në mënyrë të arsyeshme dhe në çdo rast, brenda 7 (shtatë) ditëve pasi Pala e Prekur të ketë ditur apo duhet në mënyrë të arsyeshme të dinte për ndodhinë e saj dhe pasojat e mundshme materiale që kjo Ngjarje e Forcës Madhore, ka të ngjarë të ketë mbi detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate.
- ii. Çdo njoftim sipas këtij neni, do të përfshijë edhe të gjitha hollësitë e plota të:
  - a) Natyrës dhe shtrirjes të secilës Ngjarje të Forcës Madhore dhe provave mbështetëse përkatëse, që është objekt i çdo pretendimi për lehtësim sipas Nenit 14;
  - b) Kohëzgjatjes së vlerësuar dhe pasojës apo pasojave të mundshme që ka apo do të ketë Ngjarja e Forcës Madhore mbi përmbushjen nga ana e Palës së Prekur të detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
  - c) Masave që po merr Pala e Prekur apo që ajo propozon të merren, për të lehtësuar pasojën e Ngjarjeve të Forcës Madhore; dhe
  - d) Çdo informacioni tjetër me rëndësi për pretendimin e Palës së Prekur.
- iii. Për aq sa Pala e Prekur vazhdon të pretendojë se është prekur nga Ngjarjet e Forcës Madhore, ajo do t'i japë Palës tjetër raporte të rregullta me shkrim (jo më pak se një herë në javë) me informacionet e parashikuara nga ky nen dhe informacione të tjera, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Pala tjetër.

14.9 Përfundimi nga përmbushja e detyrimeve

Nëse Pala e Prekur bëhet tërësisht apo pjesërisht e paaftë që të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një Ngjarje të Forcës Madhore, ajo do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve të saj në masën që ajo është e paaftë të përmbushë këto detyrime për shkak të kësaj Ngjarje të Forcës Madhore dhe me kusht që:

- i. Përfundimi i përmbushjes së detyrimeve të mos jetë me qëllim më të gjerë dhe kohëzgjatje më të madhe se sa kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga kjo Ngjarje e Forcës Madhore;
- ii. Pala e Prekur do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të zvogëlojë apo kufizojë dëmet e Palës tjetër, të ardhura nga apo si rrjedhojë e ekzistencës apo verifikimit të kësaj Ngjarje të Forcës Madhore; dhe
- iii. Kur Pala e Prekur është në gjendje që të rifillojë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate, ajo do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim për këtë dhe do të rifillojë menjëherë përmbushjen e detyrimeve të saj, të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

**Neni 15  
Sanksionet**

15.1. Nëse Koncesionari, brenda afatit të parashikuar në nenin 5.1. nuk dorëzon Projektin, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të sanksionojë Koncesionarin me 0.1% të vlerës së Garancisë së Kontratës për çdo ditë vonese dhe të tërheqë këtë shumë drejtpërdrejt nga Garancia e Kontratës. Ky sanksion nuk aplikohet nëse Koncesionari, jo për fajin apo neglizhencën e tij, pra për shkaqe të pavarura prej tij, nuk përmbush këtë detyrim.

15.2. Koncesionari do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të zbatuar objektin e Koncesionit në përputhje me Planin e Investimit dhe punimet sipas Tabelës së Punimeve. Në mënyrë të veçantë, Koncesionari do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira për të përmbushur Planin e Investimit dhe punimet sipas Tabeles së Punimeve në përputhje me afatet dhe zërat e parashikuara aty, sipas tregut dhe kushteve tregtare të zbatueshme. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të monitorojë zbatimin e Planit të Investimit dhe Tabelës së Punimeve.

15.3. Në rast se Koncesionari dështon në përmbushjen në kohë të fazave kryesore të Tabelës së Punimeve siç do të miratohet nga Autoriteti Kontraktues, ky i fundit ka të drejtë të sanksionojë Koncesionarin me 0.5 % të vlerës së Garancisë së Kontratës për çdo muaj vonese dhe të tërheqë këtë shumë drejtpërdrejt nga Garancia e Kontratës. Ky sanksion nuk aplikohet nëse Koncesionari, jo për fajin apo neglizhencën e tij, pra për shkaqe të pavarura prej tij, nuk arrin të përmbushë këtë detyrim.

15.4. Në rast se, brenda një viti nga miratimi i Projektit në përputhje me nenin 5.1, Koncesionari nuk ka kryer të paktën 65% (gjashtëdhjetë e pesë përqind) të vlerës së investimeve që parashikohet në Planin e Investimit, ("Investimi i Munguar"), Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues shumën e barabartë me 1% (një përqind) të Investimit të Munguar për çdo vit vonese, derisa shuma totale e Investimit të Munguar të bëhet zero. Ky sanksion nuk aplikohet nëse Koncesionari, jo për fajin apo neglizhencën e tij, pra për shkaqe të pavarura prej tij, nuk arrin të përmbushë këtë detyrim.

15.5. Në rast se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga miratimi i Projektit në përputhje me nenin 5.1, Koncesionari nuk do të ketë kryer të paktën 65% (gjashtëdhjetë e pesë përqind) të vlerës së investimeve që parashikohet në Planin e Investimit, Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues shumën e barabartë me 2% (dy përqind) të Investimit të Munguar për çdo vit vonese, derisa shuma totale e Investimit të Munguar të bëhet zero.

15.6. Pavarësisht nga sa më lart, në rast se investimet e propozuara nuk janë në përputhje me Planin e Investimit: (i) për shkak të një rasti të Forcës Madhore; apo (ii) për shkaqe apo rrethana të cilat nuk varen nga Koncesionari, jo për faj të tij, duke përfshirë por pa u kufizuar në rastet e uljes së çmimeve për shkak të kushteve të tregut ndërkombëtar apo kombëtar; ky i fundit nuk është i detyruar t'i paguajë ndonjë penalitet Autoritetit Kontraktues.

15.7. Vendosja e sanksioneve nuk përjashton të drejtën e Autoritetit për të kërkuar shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljeve të Koncesionarit.

### **Neni 16 Dëmshpërblimet**

16.1. Palët bien dakort dhe pranojnë, të mos dëmtojnë dhe të dëmshpërblejnë njëra tjetrën, në përputhje me kushtet e rëna dakort më poshtë, nga çdo dëm i shkaktuar nga mospërmbushja e detyrimeve reciproke gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

16.2. Çdo dëmshpërblim i detyrueshëm për t'u paguar nga Pala dëmshpërbluese sipas këtij neni do të jetë i pagueshëm kur: (i) është përcaktuar nga një vendim i formës së prerë i gjykatës ose nga një vendim arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i cili vendos mbi shkeljet e kryera apo përcakton se ka mospërmbushje detyrimesh dhe se dëmshpërblimi është i pagueshëm; (ii) Pala dëmshpërbluese dhe Pala e dëmshpërblues bien dakort me shkrim për një zgjidhje të ndryshme nga procedurat gjyqësore.

16.3. Pala e dëmshpërblyer, bie dakort të njoftojë menjëherë Palën dëmshpërblyese për çdo fakt që mund të rezultojë në një pretendim për dëmshpërblim sipas këtij neni, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni të këtij fakti. Nëse afati i fundit për depozitimin e një ankese ose kundërshtimi në lidhje me këtë pretendim për dëmshpërblim është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, njoftimi i duhur duhet t'i jepet Palës dëmshpërblyese nga Pala e dëmshpërblyer për t'i mundësuar respektimin e afateve ligjore, me njoftim me shkrim ku të përcaktohet pretendimi në detaje bashkë me gjithë dokumentacionin që Pala e dëmshpërblyer ka në dispozicion. Pala e dëmshpërblyer bie dakort të sigurojë, sipas kërkesës së Palës dëmshpërblyese: (i) informimin e rregullt dhe në kohë të Palës dëmshpërblyese të çdo njoftimi, komunikimi ose informacioni tjetër të marrë në çdo lloj mënyre në lidhje me çdo pretendim objekt të dëmshpërblimit; (ii) bashkëpunimin me Palën dëmshpërblyese në lidhje me zgjidhjet dhe veprimet përkatëse, duke i dhënë Palës dëmshpërblyese akses të plotë në të gjitha të dhënat dhe mbështetjen e nevojshme nga zyrtarët, drejtorët dhe të punësuarit e saj; dhe (iii) bashkëpunimin me Palën dëmshpërblyese për kryerjen e procedurave ligjore dhe/ose zgjidhjen me mirëkuptim dhe/ose nismat e tjera në lidhje me to.

16.4. Çdo pagesë dëmshpërblyese ardhur nga pretendimet e Palëve do të kryhet sipas afateve dhe procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë në bazë të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 17 Rregullimi i shkeljeve**

17.1. Kur njëra Palë konstaton se gjatë periudhës së Konçesionit Pala tjetër ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë Kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura nëpërmjet një njoftimi me shkrim këto shkelje Palës tjetër duke pritur për një periudhë 15 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse.

17.2. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja. Kjo procedurë nuk e zhvesh asnjërin Palë nga detyrimi për të paguar sanksionet dhe dëmshpërblimet që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve siç përcaktohen në nenet 15 dhe 16 dhe/ose nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara.

17.3. Procedura e mësipërme e rregullimit të shkeljeve, duhet të zbatohet paraprakisht, edhe në rastet që sjellin zgjidhjen e kontratës, si pasojë e shkeljeve të përcaktuara në nenin 18.

### **Neni 18 Zgjidhja e Kontratës**

18.1. Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme kur verifikohet një nga ngjarjet e mëposhtme:

- i. Konçesionari, nuk fillon zbatimin e detyrimeve sipas Kontratës së Konçesionit brenda 3 muajve nga data e vendosur në Projektin dhe në Tabelën e Punimeve të Kontratës së Konçesionit të miratuara sipas nenit 5.1. të kësaj Kontrate;
- ii. Konçesionari, nuk kryen të paktën 85% të investimeve të përcaktuara në Planin e Investimeve, brenda 3 (tre) viteve nga data e vendosur në Projektin dhe Tabelën e Punimeve të Kontratës së Konçesionit të miratuara sipas nenit 5.1. të kësaj Kontrate;
- iii. Konçesionari shkel dispozitat e parashikuara në nenin 7.2.3.i. të kësaj Kontrate, në lidhje me transferimin, barrësimin apo lënien peng të kuotave/aksioneve të Shoqërisë Konçesionare, pa autorizimin e Autoritetit Kontraktues;
- iv. Konçesionari falimenton ose gjendet në paaftësi paguese;
- v. Konçesionari nuk fillon zbatimin e Projektit të Konçesionit brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga afatet e përcaktuara në Tabelën e Punimeve të Projektit të miratuar, sipas nenit 5.1. të kësaj Kontrate;

- vi. Konçesionari dështon në pagesën e tarifës koncesionare për një periudhë e cila kalon 4 muaj nga afati i fundit për pagesën e saj;
- vii. Konçesionari kryen një Mospërmbushje të Përsëritur të detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate.

18.2. Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nuk e çliron Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e Kontratës deri në momentin e transferimit të plotë të aseteve të Koncesionit tek Autoriteti Kontraktues, por gjithsesi, jo përtej afatit prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga momenti i njoftimit të zgjidhjes së Kontratës, sipas përcaktimit të bërë në pikën 18.6 të këtij neni.

18.3. Konçesionari ka të drejtë të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme kur Autoriteti Kontraktues kryen një Mospërmbushje të Përsëritur të detyrimeve të tij, sipas kësaj Kontrate.

18.4. Secila Palë, nëse nuk është parashikuar ndryshe në Kontratën e Koncesionit, ka të drejtë ta zgjidhë Kontratën kur një ngjarje e Forcës Madhore zgjat në mënyrë të pandërprerë për një periudhë më të gjatë se 120 ditë, sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj Marrëveshje.

18.5. Palët kanë, gjithashtu të drejtë ta zgjidhin Kontratën e Koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

18.6. Nëse njëra nga Palët vendos të zgjidhë Kontratën sipas parashikimeve të mësipërme, duhet të ndjekë këtë procedure:

- i. Të njoftojë me shkrim Palën tjetër duke i dhënë të gjitha detajet e nevojshme të shkakut të zgjidhjes si dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm;
- ii. Informon Palën tjetër mbi datën kur kjo zgjidhje do të hyjë në fuqi, e cila në çdo rast nuk mund të jetë më pak se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike nga momenti i njoftimit.

18.7. Zgjidhja e parakohshme e Kontratës së Koncesionit nuk i zhvesh Palet nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj njëra-tjetrës dhe ndaj të tretëve, si edhe për shlyerjen e dëmeve të shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit.

#### **Neni 19 Përfundimi i Kontratës**

19.1. Kontrata Koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 10 (dhjetë) vjeçar, të përcaktuar në nenin 4 të kësaj Kontrate.

19.2. Përfundimi i Kontratës së Koncesionit nuk i zhvesh Palet nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj njëra-tjetrës dhe ndaj të tretëve, si edhe për shlyerjen e dëmeve të shkaktuara gjatë ushtrimit të aktivitetit.

#### **Neni 20 Transferimi i Aseteve**

20.1. Me përfundimin e Kontratës së Koncesionit sipas nenit 18 ose 19 më sipër, asetet fizike të Koncesionit dhe asetet hardware dhe software të Konçesionarit me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenin 8.1, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.

20.2. Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:

- i. Dorëzimin fizik të aseteve;
- ii. Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asete;
- iii. Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me këto asete;
- iv. Kalimin e titullit të pronësisë të aseteve;

20.3. Për këtë qëllim Palët do të hartojnë dhe të nënshkruajnë një proces verbal dorëzimi, i cili liston asetet e dorëzuara si dhe përshkruan gjendjen e tyre në momentin e dorëzimit;

20.4. Në çdo rast, të gjitha të drejtat dhe interesat e Konçesionarit ndaj aseteve të Koncesionit, do t'i kalojnë Autoritetit Kontraktues në datën e zgjidhjes ose të përfundimit të kësaj Kontrate, të lira nga çdo barrë dhe pa pasur nevojë për akte apo vendime të mëtejshme nga Konçesionari ose Autoriteti Kontraktues. Dorëzimi i aseteve të Koncesionit do të kryhet pa asnjë kosto për Autoritetin Kontraktues. Përgatitja e procesit të dorëzimit do të fillohet të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj përpara datës së mbarimit të Kohëzgjatjes së Koncesionit, me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

### **Neni 21**

#### **Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

21.1. Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

21.2. Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të përpiqen që të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet midis tyre ose në lidhje me këtë Kontratë me mirëbesim dhe nëpërmjet negociimit të drejtpërdrejtë. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, fuqinë, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe zgjidhjen e kësaj marrëveshje do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre (3) arbitrash, në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit (Rregullat e "DHNT"). Secila Palë ka të drejtë të caktojë një (1) arbitër. Arbitri i tretë do të caktohet nga dy arbitrat e zgjedhur nga Palët. Në rast se arbitrat nuk bien dakort për arbitrin e tretë, ky do të zgjidhet në përputhje me Rregullat e DHNT. Duke iu nënshtruar zbatimit të procedimeve të arbitrazhit, Palët heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme e të pakushtëzuar nga e drejta e tyre për çfarëdo lloj forme ankimi, rishikimi apo rekursi përpara çdo gjykate.

21.3. Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedurave të arbitrazhit, do të jetë gjuha angleze.

### **Neni 22**

#### **Të ndryshme**

##### **22.1. Ndryshimi i Legjislacionit dhe i Kushteve Ekonomike**

Nëse në cdo kohë, pas Datës Efektive Konçesionari pëson një rritje në kosto apo pakësim në bilancin neto pas taksimit apo barrë të tjera, me masën mbi 20 %, të justifikuar me dokumentacionin përkatës, përfshirë por pa u kufizuar kur rritja apo pakësimi është rrjedhim i një ndryshimi në ligj, Konçesionari mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Konçesionari, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky ndryshim në ligj, që ka sjellë si rrjedhim rritje të kostove, pakësim në të ardhurat apo barrë tjetër financiare. Autoriteti Kontraktues do ti komunikojë me shkrim Konçesionarit qëndrimin e tij në lidhje me pranimin ose refuzimin e propozimit të Konçesionarit për ndryshim të Kontratës si rrjedhojë e ndryshimit në ligj, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e njoftimit të Konçesionarit.

Palët bien dakord se Autoriteti nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme ndryshime të kësaj Kontrate të propozuara nga Konçesionari, në mënyrë që Konçesionari të ruajë pozitën financiare që gëzonte përpara ngjarjes.

##### **22.2. Ndryshimet e Kontratës**

Kjo Kontratë dhe Shtojcat e saj, përbëjnë marrëveshjen e plotë të arritur ndërmjet Palëve dhe çdo shtesë apo ndryshim i saj, do të kryhet vetëm me miratimin e përbashkët me shkrim të Palëve.

### **22.3. Transferimi i të drejtave**

Konçesionari nuk do të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas Kontratës së Konçesionit me përjashtim të rastit kur jepet miratimi paraprak me shkrim i Autoritetit Kontraktues.

### **22.4. Përfaqësimi i Palëve**

Me anë të një dokumenti të shkruar Palët do të emërojnë një Menaxher Projekti i cili do të jetë përgjegjës, në emër të Palës, të marrë komunikimet mbi të gjitha çështjet e lidhura me ekzekutimin e Kontratës së Konçesionit. Në rast të ndryshimit në emërimin e Menaxherit të Projektit të Palës, Palët do të lajmërojnë menjëherë njëra tjetrën. Nëse njëra Palë dështon të njoftojë Palën tjetër, atëherë kjo palë duhet të marrë përsipër pasojat që rrjedhin nga mosdhënia e këtij njoftimi.

### **22.5. Njoftimet**

Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë tek Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:

- i. bëhet në gjuhën shqipe;
- ii. bëhet me shkrim;
- iii. dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me lajmërim marrje ose me postë të shpejtë në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, ose do të dërgohet me faks (me fletën konfirmuese të dërgimit) në numrin e faksit të Palës tjetër, i cili është paraqitur më poshtë ose në një numër tjetër faksi siç mund ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër; dhe
- iv. shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjerë të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër;

- i. Nëse është dërguar dorazi, në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër);
- ii. Nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me lajmërim marrje, ose me postë të shpejtë, në datën që rezulton në lajmërimin e marrjes.
- iii. Në rastet e dërgimit me faks, njoftimi konsiderohet rregullisht i realizuar në datën dhe orën e konfirmimit të transmetimit nga dërguesi.

Autoriteti Kontraktues:

**Adresa:** Bulevardi Dëshmoret e Kombit, 4, Tiranë, Shqipëri  
**Fax:** +355 4 2228494

**Konçesionari:**

**Adresa:** Zaka & Kosta Attorneys at Law, Rr. Murat Toptani, Eurocol Business Center, Kati II, Tiranë, Shqipëri  
**Email:** [tefta.zaka@zakahosta.com](mailto:tefta.zaka@zakahosta.com)  
**Tel/Fax:** +355 4 2242932

### **22.6. Llogaritja e afateve**

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë pune me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

### **22.7. Gjuha**

Kjo Marrëveshje do të hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe. Dokumentet dhe njoftimet e referuar apo dërguar në vijim të kësaj Marrëveshje do të jenë të hartuara apo të përkthyer në gjuhën shqipe.

**22.8. Ruajtja e fuqisë së dispozitave të marrëveshjes**

Nëse për çfarëdolloj arsye, cilado dispozitë e kësaj Kontrate është apo bëhet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të preken nga palët, të cilat do të negociojnë në mirëbesim me pikësynimin që të bien dakord mbi një apo më shumë dispozita, të cilat mund të zëvendësojnë këto dispozita të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, sa më shpejt që të jetë e mundur.

**22.9. Deklarimet Paraprake dhe Shtojcat**

Deklarimet paraprake dhe Shtojcat bashkëlidhur kësaj kontrate janë pjesë përbërëse dhe integrale të kësaj kontrate.

\* \* \*

**PER AUTORITETIN KONTRAKTUES  
MINISTRI I FINANCAVE  
Z. RIDVAN BODE**

**PER KONCESIONARIN  
PËRFAQËSUESI ME PROKURË  
Z. Gadi GONEN**

---

---

**SHTOJCAT**

SHTOJCA 1 SHKRESE E MINISTRIT TE FINANCAVE PER MIRATIMIN E STRUKTURES TE BASHKIMIT TE PERKOHSHEM TE SHOQERIVE; PROKURAT E POSACME TE ANETAREVE TE BASHKIMIT TE PERKOHSHEM TE SHOQERIVE PER PERFAQESUESIN E TYRE;

SHTOJCA 2 DOKUMENTAT E TENDERIT

SHTOJCA 3 SPECIFIKIMET TEKNIKE

SHTOJCA 4 SHËRBIMET E MARKIMIT DHE MONITORIMIT

SHTOJCA 5 PLANI I INVESTIMEVE

SHTOJCA 6 SISTEMI OPERATIV

SHTOJCA 7 RINOVIMI I SISTEMIT

SHTOJCA 8 TRAINIMI I PERSONELIT

SHTOJCA 9 GARANCIA E KONTRATES

SHTOJCA 10 MARREDHENIET MIDIS PALEVE

SHTOJCA 11 PROJEKTI